

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORTI I MISIONIT

mbi

Një Sistem Cilësie për Statistikat

Aktiviteti 1.1.1: Metodologjia për zhvillimin dhe monitorimin e planit vjetor të punës për vitin 2014

Misioni i udhëhequr nga Daiva Jurelevičienė & Aldona Gibaitė-Kudžmienė,
Komponenti nr 1

Statistikat e Lituaniës
10-14 Mars, 2014

Versioni nr 1

IPA 2012

Emëri i autorit, adresa, e-mail

Daiva Jurelevičienė
Statistikat e Lituanisë
Gedimino av.29 Vilnius
Lithuania
Tel: +37052364627
Email: daiva.jureleviciene@stat.gov.lt

Aldona Gibaitė-Kudžmienė
Statistikat e Lituanisë
Gedimino av.29 Vilnius
Lithuania
Tel: +37052364821
Email: aldona.gibaite@stat.gov.lt

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	4
3.1. Rekomandimet: zhvillimi i procedurave të shkruara për planifikimin dhe monitorimin e procesit.....	4
3.2. Rekomandimet: përforsimi i monitorimit të rregullt në baza mujore/tremujore.....	5
3.3. Rekomandimet: rritja e komunikimit të brendshëm në lidhje me planifikimin dhe monitorimin.....	5
3.4. Rekomandimet: të sigurohet konsistencë mes Programit 5 vjeçar të Statistikave Zyrtare dhe Planit Vjetor si dhe relevanca e objektivave të vendosura në Programin 5 vjeçar të Statistikave Zyrtare	5
Detyrat në të ardhmen.....	6
Aneksi 1. Termat e references	7
Aneksi 2. Personat e takuar	12

Lista e Shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
TeR	Termat e Referencës
PAF	Korniza e Vlerësimit të Performances
SIPK	Time Entry System

1. Komentet e përgjithshme

Raporti i Misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Mbeshtetje për Statistikat”. Është misioni i parë që i përkushtohet planifikimit të punës statistikore në kuadër të komponentit 1 të projektit. Qëllimi i misionit ka qenë definimi i planit strategjik, që do të vendosë bazat për zhvillim të mëtejshëm të aktiviteteve për planifikimin dhe monitorimin.

Objektivat konkrete të misionit kanë qenë:

- Rishikimi i planit statistikor të punës;
- Diskutimi në lidhje me organizim më të mirë të procesit të planifikimit dhe monitorimit në ASK.

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë. Konsulentët nuk kanë mundur të realizojnë takime me Drejtorin për Planifikim, Koordinim dhe Komunikim pasi i njëjti ende nuk është emëruar.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Lituanisë.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Aktivitetet janë zhvilluar në formë seminari me pjesëmarrësit nga ASK-ja, të përmendur në termat e references. Janë diskutuar të gjitha temat e përmendura në termat e references.

Pika fillestare ka qenë lista e aktiviteteve të përmendura në termat e references. Gjatë seminarit konsulentët kanë bërë prezantimin e zhvillimit strategjik dhe planeve vjetor të veprimit, indikatorëve të performancës, monitorimit, planifikimit buxhetor dhe kohën e nevojshme për këto aktivitete. Një sesion i vecantë i është dedikuar analizimit të Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare të ASK-së. ASK ka shprehur interesim në lidhje me ndërveprimet me përdoruesit, planifikimin dhe organizimin e anketave mbi kënaqshmërinë e përdoruesve. Ka pasur edhe prezantim në lidhje me këtë temë.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

3.1. Rekomandim: zhvillimi i procedurave të shkruara për procesin e planifikimit dhe monitorimit

Pasi procesi i planifikimit përfshin stafin nga departamente të ndryshme të ASK-së, rekomandohet të përpilohen procedura të shkruara për planifikimin dhe monitorimin. Procedurat e planifikimit dhe monitorimit do të ngritin vetëdijen e stafit në lidhje me këto aktivitete dhe do të ndihmojnë organizimin më efektiv të procesit.

Procedurat e planifikimit dhe monitorimit duhet të mbulojnë këto aspekte:

- Përshkrimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit, shpërndarjen e informatave në mes të Departamentit të Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit me departamentet e tjera;
- Përgjegjësitë dhe afatet për aktivitetet e caktuara;
- Përshkrimin e indikatorëve në kuadër të Kornizës së Vlerësimit të Performancës (përkufizimet, kalkulimet, personat përgjegjës, etj);
- Afatet dhe procedurat e prezantimit të draftit të dokumentave të planifikimit dhe raporteve të monitorimit para menaxhmentit drejtues;
- Aplikimin e procedurave për rishikimin e Programit 5 vjeçar të Statistikave Zyrtare;
- Procedurat e menaxhimit të rrezikut;

- Aplikimin e procedurave për seleksionimin e indikatorëve të Kornizës së Vlerësimit të Performances, vlerësimit, rishikimit;
- Modelet e përdorura në procesin e planifikimit dhe monitorimit (p.sh. modelet për dokumentet e planifikimit, shpërndarja e informatave statistikore, tabelat e monitorimit etj.);
- Cështje të tjera relevante në lidhje me procesin e planifikimit dhe monitorimit.

3.2. Rekomandim: përforcimi i monitorimit të rregullt në baza mujore/tremujore

Është e rëndësishme të zgjerohet aplikimi i indikatorëve të Kornizës së Vlerësimit të Performances për vendimmarrje. Për këtë arsye duhet të vendoset monitorimi i rregullt në mënyrë të implementimit të asaj që është planifikuar. Duhet të bëhet monitorimi mujor/tremujor i rezultateve (bazuar në SIPK dhe në burime të tjera të të dhënave) dhe të caktohet stafi përgjegjës për këtë. Vëmendje e vecantë duhet t'i kushtohet saktësisë së diseminimit. Në vitin 2012 shkalla e saktësisë ka qenë 58%. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i vitit 2017 (të rritet shkalla e saktësisë në 90%) duhet bërë një analizë e rregullt e arsyeve të vonësës së produkteve, të diskutohet dhe të ndërmerren veprime për të evituar vonesat në të ardhmen. Gjithashtu, ASK-ja duhet të diskutojë dhe të implementojë masat, që mundësojnë informimin e përdouresve nëse ka ndryshim nga data e deklaruar e publikimit të ndonjë produkti.

3.3. Rekomandim: rritja e komunikimit të brendshëm në lidhje me planifikimin dhe monitorimin

Procesi i planifikimit dhe monitorimit përfshin stafin nga nivele të ndryshme. Është me rëndësi që i gjithë stafi të ketë qasje në informatat në lidhje me misionin e institucionit, objektivat dhe rezultatet e performancës. Kjo do t'i mundësonte stafit të përqendrohet në implementimin e aktiviteteve të planifikuara. ASK-ja duhet të shqyrtojë forma të tjera të komunikimit të brendshëm p.sh: takime dhe diskutime mes niveleve të ndryshme (departamenti, institucioni, Këshilli Statistikor), shpërndarja e dokumentave të planifikimit përmes intranetit.

3.4 Rekomandim: të sigurohet konsistenca mes Programit 5 vjecar të Statistikave Zyrtare dhe Planit Vjetor, si dhe relevanca e objektivave të vendosura në këtë Program.

Të gjitha dispozitat të përcaktuara në Programin 5 vjecar të Statistikave Zyrtare duhet të reflektohen drejtpërdrejt në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare. Në mënyrë që të sigurohet implementimi dhe monitorimi i këtij Programi, në tabelën përmbledhëse të Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare duhet të shtohet një kolonë duke që i referohet objektivave të përcaktuara në Programin 5 vjecar të Statistikave Zyrtare.

Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2014

Tabela përmbledhëse e zhvillimit të fushes statistikore në vitin 2014

Veprimet nga Programi i Statistikave Zyrtare 2013-2017	Ne kuader të kornizës ekzistuese të resurseve	Objektivi dhe përgjegjësia	Statusi dhe plani ardhshëm nga Maji 2013
1.1.1 Përmirësimi i cilësisë duke siguruar kalimin e të dhënave nga ESA 95 dhe SNA 93 në ESA 2010			
1.1.2. Rritja e efikasitetit duke e			

shkurtuar kohën e publikimit të BPV-së vjetore			
--	--	--	--

Në mënyrë që të sigurohet relevanca e objektivave të vendosura në Programin 5 vjecar të Statistikave Zyrtare, duhet të ketë procedura të shkruara për rishikimin e rregullt të këtij programi dhe të njëjtat të përshkruhen në procedurat e planifikimit dhe monitorimit (rekomandimi 3.1.). Ky proces mund të kombinohet me elaborimin e Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare. Rishikimi i programit 5 vjecar duhet të fokusohet vetëm tek ato objektiva, që me kohë bëhen jo relevante apo corientuese.

Detyrat në të ardhmen

1. Deri në Dhjetor, 2014, të zhvillohen procedurat e shkruara për planifikimin dhe monitorimin duke përfshirë përshkrimin e indikatorëve PAF (rekomandimi 3.1),
2. Të implementohet monitorimi i rregullt (mujor/tremujor) i rezultateve, i përcjellë nga diskutimet dhe veprimet konkrete (rekomandimi 2),
3. Të zgjerohet komunikimi i brendshëm lidhur me çështjet e planifikimit dhe monitorimit (rekomandimi 3.3),
4. Në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare të vitit 2016 të shtohet një kolonë, që i referohet objektivave të Programit 5 vjecar të Statistikave Zyrtare (rekomandimi 3.4),
5. Të sigurohet relevanca e objektivave të Programit 5 vjecar të Statistikave Zyrtare duke implementuar procedura të rregullta rishikimi (rekomandimi 3.4).

Aneksi 1. Termat e References

**Projekti i Binjakëzimit i BE-së
KS12 IB ST 01
Mbështetje për Statistikat**

Termat e Referencës:

Komponenti 1: Një sistem cilësie për Statistikat
Aktiviteti 1.1.1: Metodologjia për zhvillimin dhe monitorimin e planit vjetor të punës për vitin 2014

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 21 Shkurt 2014
Fillimi / Fundi i aktivitetit: 10-14 Mars 2014
Koha e raportimit: 21 Mars 2014

Rezultatet e detyrueshme të projektit:

Rezultati obligativ 1.1	Azhurnimi i planit statistikor të punës	• Standardizmi i procedurave për zhvillimin e produkteve statistikore të prezantuara deri në fund të tremujorit të 4 të projektit • Raportet e Cilësisë sipas standardeve të Eurostatit të përgatitura në 2 fusha të caktuara deri në tremujorin e 8-të të projektit	• Plani statistikor i punës • Raportet tremujore nga ana e Projektit të Binjakëzimit • Raportet e misionit • Raportet mbi Cilësinë	• Përkushtimi dhe disponueshmëria në të gjitha nivelet e stafit të dhe menaxhmentit të ASK-se • Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante • Staf i punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në periudhën mes misionëve • Resurse të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale)
Rezultati obligativ 1.2	Përgatitja e politikave dhe udhëzuesve për implementimin e sistemit për cilësi	• Udhëzuesi për sigurimin e cilësisë dhe dokumentimi i proceseve të produkteve statistikore, të përgatitur si draft deri në fund të tremujorit të 4 të projektit	• Raportet tremujore nga ana e Projektit të Binjakëzimit • Raportet e misionit	•

Subjekti/qëllimi i aktivitetit: 1.1.1

Rishikimi dhe azhurnimi i planit statistikor të punës do t'i ndihmojë ASK-së në azhurnimin e planit vjetor të punës dhe në zhvillimin e procedurave për raportimin dhe monitorimin e aktiviteteve në planin e punës. Plani është të ketë dy misione gjatë periudhës së projektit për mbështetje në finalizimin e planit të punës për vitin 2015.

Konsulentët do t'i prezantojnë përvojat e tyre stafit të ASK-së për metodat/metodologjinë e përpilimit të planit vjetor të punës – në aspektin e zgjedhjes së prioriteteve midis nevojave

ndërkombëtare dhe vendore për statistikat (p.sh kërkesat e Eurostatit për raportim), buxhetit dhe stafit në dispozicion (kompetencat dhe koha).

Konsulentët do të diskutojnë me stafin e ASK-së në mënyrë që t'i përcjellin eksperiencat e tyre dhe t'ia përshtatin ato rrethanave në Kosovë, dhe si të bëhet alokimi i resurseve gjatë ciklit të planifikimit.

Konsulentët do të shkëmbejnë përvojat me stafin e ASK-së për rëndësinë që ka përfshirja e stafit dhe e përdoruesve në procesin e planifikimit.

Konsulentët do të prezantojnë metodologjitë e tyre për përcjelljen dhe monitorimin e objektivave të definuara në planin vjetor të punës. Vëmendje e vecantë duhet t'i kushtohet afatit kohor dhe cilësisë.

ASK do të prezantojë idetë e tyre si dhe konceptin që e kanë për statistikat zyrtare në të ardhmen; Konsulentët prezantojnë konceptin e planit strategjik dhe monitorimin e strategjisë. ASK-ja poashtu do të prezantojë planet dhe pritjet që i kanë për projektin e SIDA-s në të njëjtën fushë.

Rezultati i pritur nga aktiviteti 1.1.1:

Raporti i Misionit, ku paraqiten këshilla operacionale që mund të përdoren për përkrahje të punës rreth planit punues për vitin 2014 dhe planifikimin e planit për vitin 2015. Përveç kësaj, do të diskutohet metodologjia për organizimin e procedurave të përcjelljes dhe monitorimit të planit të punës dhe strategjinë në përgjithësi.

Rekomandimet duhet të jenë praktike dhe në përputhje me madhësinë e ASK-së si organizatë.

Nëse ekspertët e projektit SIDA janë në dispozicion, do të ketë takime për diskutimin e koordinimit të metodologjive të prezantuar nga ana e projektit të SIDA-s.

Ekipi në ASK:

Z. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, ramiz.ulaj@rks-gov.net ASK (Udhëheqës i komponentit)

Ibrahim Rrustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; ibrahim.rrustemi@rks-gov.net

Fadil Bajraktari, Zyrtar për Komunikim dhe Informim; fadil.bajraktari@rks-gov.net

Arta Zyrtare e Lartë për Koordinim; arta.salihu.morina@rks-gov.net

Burim Limolli Shefi i TI-së; burim.limolli@rks-gov.net

Servete Muriqi, Zyrtare për Metodologji; servete.muriqi@rks-gov.net

Drita Sylejmani Zyrtare e Lartë për Diseminim; drita.sylejmani@rks-gov.net

Ekipi i Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologe e RTA në ASK, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Daiva Jurelevičenė, Shefe e Planifikimit Strategjik dhe Programimit të Statistikave, Statistikat e Lituanisë, daiva.jureleviciene@stat.gov.lt

Aldona Gibaitė-Kudžmienė, Zevendes Drejtoreshe, Statistikat e Lituanise,
aldona.gibaite@stat.gov.lt

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Perkthyesi

Përshkrimi i historikut për aktivitetit:

AGA (Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global) e fundit deklaron si në vijim:

Sipas ligjit të ri, ASK-ja është e obliguar të paraqesë draftin e programit shumë vjeçar të statistikave zyrtare, i cili pas diskutimit me Këshillin Statistikor të formuar, do t'i prezantohet Qeverisë për aprovim. Në lidhje me përgatitjen e programit, ASK-ja duhet të zhvillojë një strategji afatmesme mbi përafrimin e produkteve statistikore me EU acquis në fushën e statistikave zyrtare. Strategjia dhe programi duhet të zhvillohen në bashkëpunim të afërt me prodhuesit e tjerë dhe përdoruesit e statistikave zyrtare në Kosovë. Programi, si dhe planet operative vjetore, duhet të orientohen në dhënien e rezultateve duke përfshirë të gjitha aktivitetet e planifikuara, rezultatet që do të arrihen dhe datat përkatëse për Raportin e Vlerësimit të Adaptuar Global – Kosove, 5 statet. Do të ishte e dobishme gjithashtu të përfshihet një vlerësim i buxhetit, që nevojitet për realizimin e programit dhe planeve vjetore. Gjithashtu duhet të zhvillohet një sistem për monitorimin e rezultateve.

Aktivitetet që duhet ndërmerren si përgatitje për misionin:

Stafi i ASK-së duhet të sigurojë informatat e nevojshme për konsulentët:

- Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global (AGA)
- Programi i Statistikave Zyrtare 2013 -2017
- Plani i Zhvillimit Strategjik 2009- 2013
- Përkrahja Suedeze për zhvillimin e Statistikave në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) 2013
- Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2014 (ASK)
- Raporti i parë i misionit në komponentin e Cilësisë

Të aranzhojë takimet e nevojshme me subjekte relevante jashtë ASK-se:

Lista e takimeve me subjektet relevante jashtë ASK-së mund të përfshihet në programin e misionit

Aktivitetet e pritura janë:

- Sugjerimet për metodologjinë që do të përdoret për planin e punës të vitit të ardhshëm
- Planet për veprimet/misionet e ardhshme në kuadër të Projektit të Binjakëzimit

Rezultati i pritur:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportimin

- Plani i detajuar për aktivitetet e ardhshme në komponentin 1 nga ana e Projektit të binjakëzimit
- Përshkrimi i detajuar i metodologjisë dhe procedurave të punës të lidhura me planin e punës

Aneksi 1. Programi - Shkurt 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09:00	Hyrje në këtë pjesë të komponentit 1
		09:15	ASK: Përshkrimi i gjendjes aktuale, procedurave dhe metodologjia e planit të punës në ASK
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	ASK: Përshkrimi i gjendjes – vazhdim
		12:00	Dreka
		13:15	Konsulentët: përshkrimi i gjendjes aktuale, procedurat dhe metodologjia e planit punues në Statistikat e Lituaniës
		14:30	Pushim për kafe
		15:00	Krahasimi i planit të punës dhe planit në përgjithësi në mes ASK-së dhe vendeve anëtare
		16:30	Konkluzionet preliminare. Programi për ditën 2 dhe 3 të caktohet sipas marrëveshjes
2	ASK	09:00-16:00	Seminari vazhdon
3	ASK	09:00-16:00	Seminari vazhdon
4	ASK	09:00	Shkrimi i raportit
		10:30	Pushimi për kafe
		10:45	Seminari: Marrëveshja mbi rekomandimet dhe planin kohor
		12:00	Dreka
		15:00	Takim me udhëheqësin e projektit në ASK: rekomandimet, afatet kohore dhe programi i punës
5	ASK	09:00	Shkrimi i raportit
		10:30	Pushim për kafe
		10:00	Shkrimi i raportit
		12:00	Dreka
		13:15	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuarASK:

Udhëheqës i Projektit ne ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Mr. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit i Metodologjisë & TI-së, ramiz.ulaj@rks-gov.net

ASK (Udhëheqës i komponentit)

Mr. Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; ibrahim.rustemi@rks-gov.net

Mr. Fadil Bajraktari, Zyrtar për Komunikim dhe Informim; fadil.bajraktari@rks-gov.net

Ms. Arta Salihu, Zyrtare e Lartë për Koordinim; arta.salihu.morina@rks-gov.net

Mr. Burim Limolli Shef i TI-së; burim.limolli@rks-gov.net

Ms. Servete Muriqi, Zyrtare e Lartë në Metodologji ; servete.muriqi@rks-gov.net

Ms. Drita Sylejmani Zyrtare e Lartë për Diseminim; drita.sylejmani@rks-gov.net

Ekipi i projektit:

Per Knudsen, RTA

Nora Zogaj, Asistente e RTA